



Republika e Kosovës

Komuna e Gjakovës

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I lidhur me dt. 27.12.2018, ndërmjet:

1. Komunës së Gjakovës të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës Ardian Gjini, në tekstin vijues Komuna;
2. Kompanisë private “Lavdimi” Gjakovë të cilën e përfaqëson nga Bedrush Podrimja në tekstin vijues “Lavdimi”;

Hyrje

Qeveria e Kosovës synon përmirësimin e procesit të menaxhimit të mbeturinave komunale në mënyrë efikase. Në bazë të Strategjisë Kombëtare për Menaxhim të Mbeturinave (2013-2022), Qeveria e Republikës së Kosovës parasheh masa, të cilat komunat mund t'i ndërmarrin për të nxitur riciklimin, ripërdorimin dhe rrjedhimisht zvogëlimin e sasisë së mbeturinave të deponuara. Këto masa kërkojnë vetëdijesim, përkushtim, ekspertizë dhe mjete financiare nga niveli komunal. Për të ndihmuar në këtë proces, Komuna e Gjakovës është mbështetur në realizmin e pilot projektit nga Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) - programi Shërbimet e Qëndrueshme Komunale (SMS).

Qëllimi

Kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit, vendos termat e bashkëpunimit në mes të Komunës së Gjakovës dhe kompanisë private “Lavdimi” - Gjakovë, të cilat do të punojnë së bashku në drejtim të zvogëlimit të sasisë së mbeturinave. Kjo do të realizohet përmes pilot projektit i cili ka për qëllim ndarjen dhe riciklimin e tyre. Ky pilot projekt përkrahet nga organizata GIZ programi SMS, ndërsa implementohet në partneritet me organizatën jo qeveritare Green Art Center(GAC).

Objektivat e pilot projektit janë:

- Reduktimi i sasisë totale të mbeturinave përmes stimulimit të ndarjes së mbeturinave në burim;
- Krijimi i vendeve të reja të punës përmes procesit të ndarjes në burim;
- Ngritja e vetëdijes tek qytetarët për tu kujdesur për ambientin;
- Përmirësimi i shërbimeve publike për të siguruar kushte të mira mjedisore në vend
- Zgjerimi i shërbimeve publike duke rritur mbulueshmërinë e territorit;
- Krijimi i një modeli të suksesshëm të riciklimit i cili mund të shpërndahet edhe në komunat e tjera.

Neni I

Zonat e shtrirjes së këtij Pilot projekti janë Qendër dhe lagja Blloku i ri.

Neni II

Detyrat dhe Përgjegjësitë e Palëve nënshkruese të marrëveshjes

Palët nënshkruese bien dakord për rolet dhe përgjegjësitë e tyre si në vijim:

1. Detyrat e Komunës

- a. Komuna (përmes DSHPE-së) zbaton dhe mbikëqyrë obligimet që dalin nga kjo Marrëveshje Bashkëpunimit;
- b. Siguron infrastrukturën e nevojshme për ndarjen e mbeturinave të riciklueshme në pikat grumbulluese të përcaktuara në pilot projekt;
- c. Komuna cakton një zyrtar përgjegjës, i cili do të monitoroj të gjitha aktivitetet që dalin nga realizimi i Pilot Projektit si dhe do të informoj të gjitha palët për sfidat dhe ndryshimet eventuale që dalin gjatë realizimit të pilot projektit;
- d. Të mbikëqyrë për së afërmi punën e kompanisë Private “Lavdimi” në procesin e grumbullimit të mbeturinave nga pikat grumbulluese.

2. Detyrat e Kompanisë private “Lavdimi”

- a. Kompania private “Lavdimi” është përgjegjëse që të përpiloj një orar për grumbullimin e mbeturinave të riciklueshme dhe këtë duhet ta bëjë në koordinim me Komunën;
- b. Kompania private “Lavdimi” është përgjegjëse të bëjë grumbullimin e mbeturinave të riciklueshme sipas orarit, duke i transferuar ato deri në objektin e saj për trajtim të mëtutjeshëm;
- c. Kompania ka për detyrë që ta njoftoj komunën me kohë për çdo pengesë eventuale që mund të del gjatë pilotimit të projektit.

Neni IV

Çdo ndryshim, i tekstit të kësaj marrëveshje, kërkon aprovim me shkrim nga të gjitha palët.

Neni V

Kjo marrëveshje hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të saj.

Neni VI

Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme për 6 muaj dhe do mund të ripërtërihet me vullnetin e palëve, të paktën 3 (tre) muaj përpara përfundimit të afateve të vlefshmërisë.

Në rast të mos përmbushjes së obligimeve të kësaj marrëveshje nga ndonjëra palë, marrëveshja mund të shkëputet me një paralajmërim 30 ditë përpara.

Neni VII

Zgjidhja e kontesteve të rastit, për sa i përket zbatimit të kësaj Marrëveshje, do të arrihet përmes diskutimeve mes palëve.

Si më sipër u lexua, aprovua dhe u nënshkrua nga palët, në Komunën e Gjakovës, më datë 27.12.2018.

PALET

